

**AKT- THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“Realmix Albania” shpk**

Ne Kavaje, sot me date 23 Mars 2021 (dymije e njezet e nje).

Ortaku i vetem themelues:

**Z.Artan Hasalliu** datelindjes 16/04/1979, lindur ne Kavaje dhe banues ne Kavaje, shtetas shqipetar madhor, me zotesi juridike për të vepruar identifikuar me karte identiteti me numer H90416259U, me cilesine e “Ortakut themelues” kerkoi redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklroi se me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor,Fiskale Tatimor, krijon shoqerine tregetare, me perqejjesi te kufizuar, **“Realmix Albania” shpk**

**KREU I**  
**Neni 1**

**Krijimi**

**““Realmix Albania” shpk**

Eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me perqejjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

**Neni 2**  
**Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj Shoqeria **““Realmix Albania” shpk**, eshte një shoqeri tregetare, e themeluar nga shtetas shqipetar **Z.Artan Hasalliu**, i cili pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

**Neni 3**  
**Selia**

Shoqëria e ka seline në Kavaje Golem Rruga e plazhit pallati pran Hotel Flower objekt me nr.pasurie 71/78+1-4 dhe zone kadastrale 1791 Shoqëria mund të ndryshoje seline e saj , te hapë zyra përfaqësie, degë, të krijoj filiale, si brenda dhe jashtë vendit Republikës së Shqiperisë , vetëm me vendimin e Ortakut themelues .

**Neni 4**  
**Objekti i veprimitarise**

Import - eksport, duke perfshire magazinimin tregtimin dhe prodhimin me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshem ushqimore e industrial te perdonimit te gjere,te te gjitha piyeve te ndryshme alkoolike ose jo, perfshi dhe



ato energjike, sallameri e produkte bulmeti, pajisje elektroshtepiake, hidrosanitare, hidraulike, elektrike, produkte buqesore dhe blegtore, fruta - perime, produkte deti, kozmetike, konfeksione, automjete e makineri te ndryshme si dhe pjese kembimi per to, material e lende ndertimi, pllaka, artikuj mobilierie e orendi shtepiake dhe mobilime zyrash, artikujve te ndryshem te perdonur si rroba, kepuce, orendi shtepiake etj. ndertim, montim dhe fiksim I urave te betonit, sherbime ne fushen e ndertimit si carpenter, hekurthyes, murator, pllakashtrues, suvatime te ndryshme etj. Veprintari prodhuese ne te gjitha deget e industrise se lehte dhe ushqimore si dhe te industrise se rende. Pike servisi dhe sherbim mjetesh motorike, lavazh, hoteleri - turizem, bar - kafe, restorant. Transport mallrash dhe udhetaresha brenda dhe jashtë vendit per vete dhe per te trete. Hapjen e agjesive imobiliare per shitblerje dhe dhenie me qira te pasurive te paluajtshme.

**Neni 5**  
**Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**KREU II**

**Kapitali**

**Neni 6**

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mijë) leke, i ndare ne 1 kuote me vlore nominale 100.000 (njeqind mijë) leke, i nenshkruar plotesisht nga ortaku vetem themelues ne masen 100%. Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlore te tregetueshme. Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme te paluajtshme apo te drejta). Ortaku i vetem per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te kapitalit themeltar te shoqerise.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuota e kapitalit tenje shoqerie me per gjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.



Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate perqjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

**KREU II**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**  
**Neni 8**  
**Organi Vendimmarres**

Ortaku i vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise.Ortaku i vetem eshte organi vendimmarres i shoqrise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statute duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku vendos per çeshtje si :

- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku vetem regjistrohen ne nje register te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhen regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per :

- a) Miratimine pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim , perveç rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rr Ethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

**Neni 9**  
**Administrimi**

Administrator i shoqerise "**Realmix Albania**", caktohet Z.Artan Hasalliu, i cili emerohet per nje afat 5 vjeçar me te drejte ripertritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te vetem themelues te shoqerise.

**Neni 10**  
**Kompetencat**



Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqrise, duke zbatuar politikat tregetare, te vednosura nga asambleja e per gjithshme;
- b) Perfaqesoje shoquerine tregetare;
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoquerise;
- d) Pergatisi dhe nenshruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shpendarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se per gjithshme per miratim
- e) Krijoi nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoquerise
- f) Kryej regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqrise sic parashikohet ne ligjin per QKR.
- g) Raportoi perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoquerise tregetare.

Administratori eshte i detyruar te therrase ne mbledhjen e asamblese ne rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston tereziku qe aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri,qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoquerise,qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratoret, se bashku edhe vecas njeri tjeterit, kane te drejte te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtzakonshem. Administratoret e perfaqesojne Shqiperine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoritetete shteterore shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkallev. Administratoret kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoquerise, ne te gjitha rr Ethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakeve te shoquerise.

Administratoret angazhojne shoquerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoquerise ose per te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rr Ethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk esht prove e mjaftueshme.

### Neni 11 Viti Financiar

Viti Financiar i shoquerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i parefinanciar fillon nga data e regjistrimit te shkoqerisë ne QKR dhe mbylltet ne 31 dhjetor.

### Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqueris mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohe zgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te ortakve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit



- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk esht njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombtare te Regjistrimit"
- e) me vendim te gjykates

Ne kete rast Asamblea merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqeris, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "shoqli ne likuidim e siper".

### Neni 13

#### **Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit "Per tregtaret dhe shoqerit tregtare", Kodit Civil dhe cfar do ligji tjeter specific ne Republiken e Shqiperis

### Neni 14

#### **Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemlare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare Shpk, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**SHTETASI SHQIPETAR**

**Artan Hasalliu**

